Protokoll Nr 5.

Ky protokoll mbahet sot më datë 25.5.2026, ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të KB Divjakë, kati i dytë në godinën e Bashkisë Divjakë, për zhvillimin e mbledhjes së rradhës së KB për muajin Maj 2026.

Në mbledhje morrin pjesë këshilltorët:
Lin Bizi, Ardian Vocko, Donika Stoso,
Alketa Gonekaj, Julian Vrapi, Elona Stambolliu,
Shpëtim Sheshi, Xhorxhi Kruti, Indrit Zejno,
Gojart Apolli, Jurgen Shuli, Roza Broshka,
Ardjan Shurdhaj, Majlinda Xhoro, Mishel Qendro,
Sohit Ibrahimaj, Seit Lojo, Sokol Koleshi,
Antuela Gjini, Adelajda Çuli.

Kuorumi për zhvillimin e mbledhjes u plotësua, Kryetarja zj. Lin Bizi e deklaron mbledhjen të hapur dhe kalon në Rendin e Ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes që u zhvillua në datë 24.04.2026.
3. Informacion mbi zbatimin e VKB Divjakë për m. Prill 2026.
4. Projektvendim Nr. 41 datë 11.5.2026 - Mbi miratimin e përfundimit të procedurës së privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK pronë DV Lushnje.
5. Projektvendim Nr 42 dt. 11.5.2026 - Për transferimin e asetit "Furnizimi me ujë për 2 bregdetare të B. Divjakë dhe Nj. Adm. Remas" në Shoqerinë Rajonale të UK Lushnje Sh.A.
6. Projektvendim Nr. 43 dt. 12.5.2026 - Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Prill 2026.
7. Projektvendim Nr 44 dt. 13.5.2026 - Për disa ndryshime në VKB nr 89 dt. 29.12.2025 "Për miratimin e nr të punonjësve të Bashkisë, Instit. në varësi të Nj Adm dhe funks. të deleg. për v. 2026
8. Projektvendim Nr 45 dt. 14.5.2026 "Për mirat. e Progr. të Transparenc."
9. Projektvendim Nr. 46 dt. 15.5.2026. Për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga KJ DV që kanë mbetur pa u regjistr. në ASHK Lushnje
10. Projektvendim Nr. 47 dt. 15.5.2026: Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare, shtetasve të cilëve u janë dëmtuar banesat nga fatkeqësitë e F.
11. Projektvendim Nr. 48 dt. 15.5.2026: Për miratimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar në programin "Emergjencat civile".

Project: Date ...... /...... / ..........

12. Projektvendim Nr. 49 dt. 15.5.2026 "Për një ndryshim në VKB nr 90 dt. 29.12.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonj-ësve të Bashkisë, Instit. në varësi dhe Nj. Adm. për v. 2026.

1. Pika e parë e rendit të ditës
- Miratimi i rendit të ditës.

Kryetarja znj. Din Bili i drejtohet këshilltarëve: A kemi pyetje, shtesa, pyetsime rreth rendit të ditës?
Merr fjalën Nënkryetari i KB z. Indrit Zgjana dhe propozon këshilltarëve që: Të hiqet nga rendi i ditës Projektvendimi Nr. 48 dt. 15.5.2026 "Për miratimin dhe përdorimin e fondit të kushtë-zuar në programin "Emergjencat Civile"
Pyetje z. Ardjan Shurdhaj: Përse hiqet nga rendi i ditës ky projektvendim. Përgjigjet znj. K. Rrudha, ku shprehet mbi kodet që do të përdoret ky fond dhe në këto kode duhej të përfshihej fondi për investime, ndërsa në Prevent. ne kemi propozuar këtë fond për shpenzime. Pyetje të tjera s'ka.
Hidhet në votim pika e parë e rendit të ditës dhe votohet me ndryshimin, për heqjen e pikës 11 të [illegible], me 17 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

2. Pika e dytë e rendit të ditës.
- Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes që u zhvillua më dt. 24.4.2026.

Pyetje s'ka, diskutime s'ka. Hidhet në votim pika e dytë e rendit të ditës dhe votohet me 17 votë pro, asnjë vot abstenim, dhe asnjë votë kundër.

3. Pika e tretë e rendit të ditës.
- Informacion mbi zbatimin e VKB për muajin Prill 2026.

Pyetje z. Ardjan Shurdhaj: Përse në këtë informacion nuk i është bashkangjitur Përgjigja e Prefekturës për Vendimet e KB?
Përgjigjet sekretari i KB: Përse të gjitha Vendimet janë Vendime me karakter individual dhe kolektiv, nuk dërgohen në Prefekturë për konfirmim, Prefektura konfirmon VKB me karakter normativ.
Kalohet në leximin e Raporteve të Komisioneve për shqyrtimin e projektvendimeve, ku për Komisionin e Ekonomisë lexoi raportin këshilltari z. G. Apolli duke u shprehur: Komisioni në mbledhjen e dt. 22.5.2026 vendosi të kalojë për miratim projektvendimet nr 42, 43, 44, 45, 47, 49 dt. 15.5.2026, të cilët u votuan me 4 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë v. abstenim.

4. Pika e katërt e rendit të ditës.
- Mbi miratimin e përfundimit të procedurës së privatizimit të banesave

të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK pronë DVK Rrushbull Kashar.
Kryetarja zj. Lira Bili i jep fjalën për relatim z. A. Ballori, ku i propozoi këshilltarëve që të miratojnë përfundimin e privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar, ku është qytetari:
Ibrahim Hamit Kolonjari. Pyetje nga këshilltarët s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e katërt e rendit të ditës dhe votohet me 17 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim. Erdhën 2 këshilltarë zj. A. Culi dhe z. A. Vodo. Janë prezent 19 këshilltarë në sallë.

5. Pika e pestë e rendit të ditës
- Për transferimin e asetit "Furnizim me ujë për zonat bregdetare të Bashkisë dhe Nj. Adm. Remas në shoq. Rajonale UK Rrushbull sh.a.
Kryetarja i jep fjalën për relatim zj. K. Rrudha, e cila i propozoi këshilltarëve të miratojnë transferimin e këtij aseti, investimi i cili është marrë në dorëzim përfundimtar me certifikatën nr 607 prot. dt. 23.01.2026. Vlera e investimit është 496 124 988 lekë dhe vlera e mbikqyrjes së punimeve është 4 301 243 lekë me TVSH.
Kryetarja zj. Lira Bili: A kemi pyetje apo diskutime?
z. A. Shurdhaj: Përse nuk e menaxhojmë vet këtë aset, sepse dhe shërbimet janë nga ana jonë më afër qytetarit. Unë e diskutova dhe në mbledhjen e parë dhe jam kundër transferimit të këtij aseti.
Përgjigjet Kryetari i Bashkisë: Është marrë me përpara VKB për transferimin e ujësjellsave dhe është miratuar; ku në këtë shoqëri kemi % aksionerie, por që duhet të transferohet sepse qeveria nuk na alokon fonde dhe punonjës për mirëmbajtjen e ujësjellsit, por i a nis Shoqërisë Rajonale UK Rrushbull SH.A.
Diskuton për këtë pikë dhe z. Shpëtim Sheshi ku theksoi se nuk mund të mbahet nga Bashkia ky ujësjellës, sepse fondet qeveria i kalon në Sh.A. Rrushbull. Erdhi këshilltari z. Xh. Veruti.
Pyetje të tjera nuk ka, diskutime s'ka. Hidhet në votim pika e pestë e rendit të ditës dhe votohet me 17 vota pro, 2 vota kundër dhe 1 këshilltar nuk merr pjesë në votim.

6. Pika e gjashtë e rendit të ditës.
- Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar -6% për m. Prill 2026.
Relatoi Përgjegjësi i S. M. Soc dhe Përkujd. Shoq. z. A. Muça, ku i propozoi këshilltarëve të miratojnë 13 familje për ndihmë ekonomike me fondin e kushtëzuar 6% për muajin prill prej 63223 lekë të cilat janë E. Ziu 10692 lekë, A. Rrapi 5940 lekë E. Gjoka 7920 lekë, V. Sula 5940 lekë, Y. Allajrami 1525 lekë,

Project: Date ...... / ...... / ..........

A. Meta, 5227 lekë, M. Krosniqi 2178 lekë, B. Gjini 1525 lekë
Z. Zeqiri 3703 lekë, N. Dosti 5227 lekë, S. Muça 5940 lekë,
B. Gorka 3703 lekë, Xh. Ndoni 3703 lekë

Pyetje s'ka, diskutime s'ka.

-Hidhet në votim pika e gjashtë e rendit të ditës dhe votohet me 20 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

7. Pika e shtatë e rendit të ditës.

-Për disa ndryshime në VKB nr. 84 dt. 29.12.2025 "Për miratimin e nr. të punonj. Bashkisë, instit. në varësi, Nj. Adm + funks. deleg. për v. 2026. Relatoi Drejt. e Sektorit të Burimeve Njerëzore pranë Drejtorisë zj. A. Simaku, dhe i propozoi këshilltarëve të miratojnë shkurtimin e Sekt. të Shërb. Turistike me 9 punonjës, shkurtimin e pozicionit 1 punonjës tregu, shkurtimin e 13 pozicioneve në ASHK. Nga këto shkurtime nr. i punonjësve të Bashkisë ndryshon nga 141 në 131 Nr. i punonjësve të ASHK ndryshon nga 115 në 102, dhe Nr. i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë ndryshon nga 486 punonjës në 463 punonjës, duke u shkurtuar gjithsej 23 pozicione pune të cilat do të shtohen tek Shoqëria "Rrjedha Shpk.

Pyetje z. G. Apolli: Këta punonjës do të punojnë tek Shoqëria?

Përgjigjet zj. A. Simaku: Po. Këta punonjës do të punojnë tek Shoqëria. Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka. Hidhet në votim pika e shtatë e rendit të ditës dhe votohet me 20 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

8. Pika e tetë e rendit të ditës.

-Mbi miratimin e Programit të transparencës së Bashkisë Divjakë. Relatoi z. A. Bullari i cili i propozoi këshilltarëve të miratojnë Programin e transparencës për Bashkinë Divjakë, sipas formatit tip, të bashkëlidhur relacionit, duke u mbështetur në Urdhrin Nr. 281 dt. 30.12.2025 të Komisionerit për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave personale.

Pyetje z. A. Vodo: Ky program është live në fq. e Bashkisë?

Përgjigjet z. A. Bullari: Po, është në fq. e web-it të B. Divjakë.

z. G. Apolli: Ky program duhej të ishte propozuar më përpara.

Pyetje dhe diskutime të tjera për këtë pikë nuk ka. Hidhet në votim pika e tetë e rendit të ditës dhe votohet me 20 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

9. Pika e nëntë e rendit të ditës.

-Për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga Nj.Q.V e cila ka mbetur pa u regjistruar në ASHK. [illegible]

Relaton z. A. Balloni, ku i propozoi këshilltorëve që të miratojnë përfundimin e procedurës së regjistrimit të trojeve të dhëna për ndërtim nga NJ.V sipas dokumentave në dosjen e znj. Hoda Teonjis.
Tjetër s'ka. Diskutime s'ka. Hidhet në votim pika e nëntë e rendit të ditës dhe votohet me 20 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

10. Pika e dhjetë e rendit të ditës.
- Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare, shtetasve të cilëve u janë dëmtuar banesat nga fatkeqësi të ndryshme.
Relatoi specialisti i emergjencave civile z. F. Dosja, ku i propozoi këshilltorëve që të miratojnë dhënien e ndihmës financiare qytetarëve: z. Mustafa Muça me një ndihmë prej 1.578.901 lekë,
z. Erjon Shehu me një ndihmë financ. prej 852.714 lekë.
z. Ernest Dosja me një ndihmë financiare prej 286.451 lekë.
z. Fatmir Kocabyme me një ndihmë financ. prej 1.330.950 lekë.
z. Bajar Manaj me një ndihmë financiare prej 1.828.425 lekë.
Burimi i financimit është nga fondi i kushtëzuar për vitin 2026 transferuar nga Ministria e Mbrojtjes "Emergjencat civile, artik. 604 kodi i produktit 91707AB (për shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme".
Tjetër. z. S. Ibrahimaj: Fondi, nga kush do të përballohet, nga Bashkia apo nga Ministria e Mbrojtjes? Përgjigjet specialisti i emergj. civile: Ky fond ka ardhur nga Ministria e Mbrojtjes për emergjencat civile.
Tjetër z. G. Apolli: Si do merret kjo ndihmë, me kesh në dorë?
Përgjigjet z. A. Balloni: Do hapin nr. llog. në Bankë dhe do ti hidhet ky fond. Sqaroi dhe Kryetari i Bashkisë: Do të ndjekim rastet një për një, nëse kanë kaluar njëherë në Këshill.
Tjetër dhe diskutime të tjera nuk ka.
Hidhet në votim pika e dhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 20 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

11. Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës, u hoq nga Rendi i ditës.

12. Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës.
- Për një ndryshim në VKB nr 90 dt. 29.12.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë, Inst. në varësi dhe të Nj. Adm. për vitin 2026.
Relatoi Drejtori i Financës dhe Buxhetit z. Xh. Brahkola, ku i propozoi këshilltarëve të miratojnë një ndryshim në VKB nr 90 dt. 29.12.2025, sipas lidhjes nr 1 për pozicionin Jurist pranë Agjencisë së Shërbimeve Komunale të rritet me 10000 lekë, pra:

pagë për pozicion Jurist ishte 60.000 lekë të bëhet 70000 lekë.
Sqaron Këshilltorët dhe Kryetari i Bashkisë për rritjen e pagës si pozicionit të kategorisë Jurist.
Pyetje z. A. Vodo: A mund të jetë më e lartë se propozimi juaj?
z. A. Shurdhoqi: A ka mundësi të shikohet dhe ti jepet dhe punëdhënës e kolucë si e propozuar?
Përgjigjet z. Xh. Brahkola, Drejtor i Financës dhe Buxhetit. Propozimin tonë jua kemi paraqitur në dr. vendimi. Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e dymbedhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 20 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.
Kryetarja zj. Lin Bili i drejtohet këshilltorëve: Rendin e ditës e mbaruam, prandaj kalojmë në zërin Të tjera.
zj. A. Conaku: Kemi një shtyllë elektrike tek posta një shtëpie dhe po bëhet në rrezik për jetën e familjarëve. A ka mundësi të largohet kjo shtyllë? Përgjigjet z. A. Jauko: E jemi në dijeni dhe i kemi bërë 2-3 kërkesa OSHE. Sqaron dhe Kryetari i Bashkisë për këtë problematikë.
zj. A. Conaku: Tek shtëpia e z. Veliqi në grabjan ka një gropë të zezë hapur.
Përgjigjet z. A. Jauko, E jemi në dijeni dhe kemi bërë kërkesë për tubo.
z. A. Vodo: A do pastrohet bregdeti për sezonin veror?
Përgjigjet Kryetari i Bashkisë mbi masat e marra në këtë drejtim.
z. S. Ibrahimaj: Kur do shtrohen rrugët bujqësore, se t fermerët janë në kulmin e punës, vetëm kërkohet sistemimi i dherave, sepse janë rrugë dytësore, këtë problematikë kam parë, kam dhe do të vazhdoj të kërkoj nga ana juaj.
Përgjigjet Kryetari i Bashkisë: Për sistemimin e rrugëve i kemi marrë me radhë të gjithë fshatrat, dhe do të vijmë dhe në Ferras.
z. S. Ibrahimaj: Kemi një lagje me 15 familje ku nuk janë vendosur koshe mbetjesh. E kam ngritur këtë problem gjithnjë dhe akoma nuk është zgjidhur.
z. G. Apolli: Kanalet vaditës nuk janë pastruar dhe nuk ujë për vaditje kur do pastrohen Kryetar? Përgjigjet Kryetari.
z. Arqile Shurdhoqi: Po fillon punimet e korrjeve, rrugët e parcelave, a do të shtrohen për kalimin e mjeteve?
Përgjigjet Kryetari i Bashkisë z. J. Gorrea:
Po i marrim me radhë të gjithë zyrat Administrative për këtë problematikë, dhe kemi filluar për shtrimin e rrugëve të parcelave.

Project: Date ...... /...... / ..........

Pyetje të tjera s'ka, diskutime të tjera s'ka.
Kryetarja znj. Liri Bitri e deklaroi mbledhjen e
KB për muajin Maj 2026 të mbyllur.
Procesverbali u mbajt nga Sekretari i KB.

Sekretari i KB
Mimoza Gjomoj

Kryetare e KB
Liri Bitte

Athina Veshaj

Gh. Gheza

Roza Troshku

Elona Stambolliu

Albana Çaçelli

Majlinda Xhaxo

Adelajda Guli

Sokol Kaloshi

SEIT BASHO

Antuela Gjini

Donika Stasa

Indrit Zajmi

Iljir Vrapi

Fatgen Shehi